

MEKTRIN MOTORS sh.p.k

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

PËRMBAJTJA

	Faqe
Pasqyrat Financiare	
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1-2
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE	6
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	7 – 22

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Drejtimin dhe Ortakun e vetëm të Shoqërisë Mektrin Motors sh.p.k

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë **Mektrin Motors sh.p.k** (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 Dhjetor 2016, pasqyrën e performancës, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 Dhjetor 2016, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara në Shqipëri.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

30 qershor 2017



Irena Hoxha
Auditues Ligjor



Rr. Emin Duraku, Pall. "Binjaket",
No.5, 1000, Tirana, Albania
phone: +355 42 27 30 15
www.mazars.al, info@mazars.al

MEKTRIN MOTORS sh.p.k.
Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 dhjetor 2016

Të gjitha vlerat janë në Lekë

Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2016

	Shënime	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	71,634,948	6,478,917
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	144,648,557	123,588,259
Të tjera llogari të arkëtueshme	6	34,425,924	359,723
Inventarë	7	508,144,252	432,489,574
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	8	4,128,220	-
Totali i aktiveve afatshkurtra		762,981,901	562,916,473
Aktivët afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	9	255,772,862	28,034,486
Totali i aktiveve afatgjata		255,772,862	28,034,486
Totali i aktiveve		1,018,754,763	590,950,959
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	10	108,185,804	48,125,153
Llogari të pagueshme tregtare	11	205,249,712	92,285,658
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	12	92,448,866	92,248,866
Parapagime të marra	13	63,548,548	3,004,164
Detyrime tatimore	14	446,350	4,399,334
Të tjera detyrime	15	2,326,613	4,265,283
Totali i detyrimeve afatshkurtra		472,205,893	244,328,458
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	16	159,348,931	-
Totali i detyrimeve afatgjata		159,348,931	-
Totali i detyrimeve		631,554,824	244,328,458
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar		35,000,000	35,000,000
Rezerva ligjore		1,750,000	1,750,000
Rezerva të tjera		309,872,501	200,144,799
Fitime të mbartura		-	-
Fitimi i ushtrimit		40,577,438	109,727,702
Totali i kapitalit	17	387,199,939	346,622,501
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		1,018,754,763	590,950,959

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

MEKTRIN MOTORS sh.p.k.
Pasqyrat Financiare më 31 dhjetor 2016

Të gjitha vlerat janë në Lekë

Pasqyra e Performancës
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	18	1,277,281,544	1,631,599,754
Puna e kryer nga njësia ekonomike e kapitalizuar	19	188,092,079	-
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	20	6,267,124	3,478,180
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe të tjera shpenzime	21	(1,387,816,561)	(1,483,696,219)
1) Mallra, materiale të konsumueshme dhe shpenzime të tjera		(1,179,951,829)	(1,444,585,444)
2) Lëndë të para dhe materiale për prodhimin e aktiveve		(166,612,836)	-
3) Të tjera shpenzime	22	(41,251,896)	(39,110,775)
Shpenzime të personelit	23	(17,561,966)	(13,233,687)
1) Paga dhe shpërblime		(15,170,106)	(11,428,017)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore		(2,391,860)	(1,805,670)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	24	(6,629,890)	(5,631,329)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	25	(1,154,913)	(854,945)
Zhvlerësim i aktiveve financiare dhe investimeve të mbajtura si aktive afatshkurtra	5	(4,230,805)	-
Shpenzime financiare		(5,474,573)	(2,319,378)
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme	26	(8,692,070)	(4,046,220)
2) Shpenzime të tjera financiare	27	3,217,497	1,726,842
Fitimi/humbja para tatimit		48,772,039	129,342,376
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	28	(8,194,601)	(19,614,674)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(8,194,601)	(19,614,674)
2) Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë		-	-
Fitimi/humbja e vitit		40,577,438	109,727,702
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		40,577,438	109,727,702

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

MEKTRIN MOTORS sh.p.k.
Pasqyrat e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të gjitha vlerat janë në Lekë

Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva ligjore	Rezerva të tjera	Fitimet e pashpërndara	Fitim/ Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 1 janar 2015	35,000,000	1,750,000	131,903,213	-	68,241,586	236,894,799
Totali i të ardhura gjithpërfshirëse për vitin:					109,727,702	109,727,702
Transferim në rezerva			68,241,586		(68,241,586)	-
Dividendë të paguar						-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2015	35,000,000	1,750,000	200,144,799	-	109,727,702	346,622,501
Totali i të ardhura gjithpërfshirëse për vitin:					40,577,438	40,577,438
Transferim në rezerva			109,727,702		(109,727,702)	-
Dividendë të paguar						-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2016	35,000,000	1,750,000	309,872,501	-	40,577,438	387,199,939

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 janë aprovuar nga administratori i Mektrin Motors sh.p.k. më _____ 2017 dhe janë firmosur si më poshtë.

Z. Arjan Cyrbja
Hartues i Pasqyrave Financiare

Z. Edmond Shahini
Administrator

Të gjitha vlerat janë në Lekë

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	40,577,438	109,727,702
<i>Rregullimet për shpenzimet jomonetare:</i>		
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	-	3,785,821
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	6,629,890	5,631,329
Zhvlerësime për llogari të arkëtueshme	4,230,805	-
Diferenca këmbimi jo nga aktivitetet operative	(4,931,391)	(2,043,231)
Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:		
Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	(185,456)	-
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(59,357,304)	34,374,195
Rënie/(rritje) në inventarë	(78,983,580)	(108,831,000)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	106,200,965	(9,343,494)
Rritje/(rënie) në parapagime të marra	60,544,384	(4,574,694)
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	272,117	299,675
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	74,997,868	29,026,303
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(241,923,810)	(17,851,100)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	7,741,000	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(234,182,810)	(17,851,100)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Hua të arkëtuara	223,194,554	-
Pagesa e huave	-	(69,629,546)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	223,194,554	(69,629,546)
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	64,009,612	(58,454,343)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	6,478,917	64,583,872
<i>Efekt i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare</i>	1,146,419	349,389
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	4 71,634,948	6,478,917

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria MEKTRIN MOTORS sh.p.k është themeluar më 12.01.2005 dhe regjistruar pranë QKR më 08.02.2005 me NIPT K51408501P. Veprimtaria e saj rregullohet nga statute i saj si dhe nga ligji nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Shoqëria MEKTRIN MOTORS sh.p.k është një person juridik privat me përfaqësues ligjor dhe ortak të vetëm Z. Edmond Shahini i cili zotëron 100% te kuotave te kapitalit. Kapitali i regjistruar i shoqërisë është 35,000,000 Lekë.

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është tregtia me shumicë e pakicë e makinave dhe pjesëve të tyre, dhënia me qera e automjeteve të çdo lloji, marrja e përfaqësise në aktivitetin tregtar të automjeteve, tregtimi, dhënia me qira e mjeteve detare lundruese të çdo lloji, ndryshime konstruktive të mjeteve motorrike tokësore dhe mjeteve ujore të çdo lloji.

Selia e Shoqërisë ndodhet në autostradën Durrës – Tiranë km 6, Xhafzotaj, Durrës.

Numri i punonjësve në 31 dhjetor 2016 ka qënë 39 punonjës.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme (vazhdim)

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.1. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Kur është e nevojshme, shifrat krahasuese axhustohen (rregullohen) në konform me ndryshimet në paraqitje në periudhën aktuale raportuese. Ndryshimet janë kryer për të paraqitur më mirë natyrën e biznesit të Shoqërisë. Ato aplikohen retrospektivisht.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.5. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
EUR/LEK	135.23	137.28
USD/LEK	128.17	125.79

Të gjitha vlerat janë në Lekë

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.6. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Të gjitha vlerat janë në Lekë

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Kapitali themeltar

Kapitali njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

Të gjitha vlerat janë në Lekë

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2016 dhe 2015 është si më poshtë:

<u>Kategoria e aktiveve</u>	<u>Metoda e Amortizimit</u>	<u>Norma e Amortizimit</u>
Ndërtesa		5%
Makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	20%
Pajisje zyre dhe informatike	Vlera e mbetur	25%
Mobilje zyre	Vlera e mbetur	20%
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20%

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2016 është 15% (2015: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohshme për njohjen e tatimi të shtyrë.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.13. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

MEKTRIN MOTORS sh.p.k.
Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

Të gjitha vlerat janë në Lekë

4. Mjete monetare

Balanca e likuiditeteve të shoqërisë më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 paraqitet si më poshte:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Mjete monetare në bankë	71,323,361	3,695,301
Në lekë	3,138,556	2,026,955
Në valutë	68,184,805	1,668,346
Mjete monetare në arkë	311,587	2,783,616
	<u>71,634,948</u>	<u>6,478,917</u>

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Në këtë zë janë kërkesat e arkëtueshme ndaj klientëve, balanca e së cilave më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 paraqitet si më poshte:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Klientë	148,879,362	123,588,259
Zhvlerësim për klientë	(4,230,805)	-
	<u>144,648,557</u>	<u>123,588,259</u>

Levizjet ne zhvleresimin e te drejtave per arketim:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Gjendja mw 1 janar	-	-
Zhvlerësimi për vitin	(4.230.805)	-
Rimarje për vitin	-	-
Gjendja mw 31 dhjetor	<u>(4.230.805)</u>	<u>-</u>

6. Llogari të arkëtueshme të tjera

Në këtë zë janë paraqitur llogaritë e arkëtueshme të tjera, të cilat detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Garanci bankare	6,176,225	245,456
Garanci të tjera	733,449	-
Detyrime doganore të mbipaguara	-	114,267
Tatimi mbi fitimin	9,623,639	-
TVSH për t'u arkëtuar	17,892,611	-
	<u>34,425,924</u>	<u>359,723</u>

Të gjitha vlerat janë në Lekë

7. Inventari

Inventari më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Mallra për rishitje/ Pjesë këmbimi automjete	64.053.334	67.095.109
Mallra për rishitje/ Pjesë këmbimi kamiona	2.258.110	201.987
Materiale të para	6.320.120	-
Kamiona në magazinë	10.006.066	38.146.566
Automjete për rishitje	363.044.080	301.711.142
Lëndë djegëse	453.627	460.134
Mallra në tranzit	43.987.209	-
Parapagime për furnizime	18,021,706	24.874.636
	<u>508,144,252</u>	<u>432.489.574</u>

8. Parapagime dhe shpenzime të shtyra

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Parapagime per furnitorë	4.128.220	
	<u>4.128.220</u>	<u>-</u>

MEKTRIN MOTORS sh.p.k.
Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2016

Të gjitha vlerat janë në Lekë

9. Aktive afatgjata materiale

	Ndërtesa	Makineri dhe pajisje	Mjete transporti	Mobilije zyre dhe pajise Informatike	Asete në Proçes	Totali
<i>Kosto</i>						
Gjendja më 1 janar 2015	2,856,529	6,562,621	8,259,932	10,778,044	169,196	28,626,322
Shtesa	-	2,637,941	13,776,000	1,437,159	-	17,851,100
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2015	2,856,529	9,200,562	22,035,932	12,215,203	169,196	46,477,422
Shtesa	-	7,827,129	20,980,000	18,009,211	195,107,470	241,923,810
Pakësime	-	-	(12,158,500)	-	-	(12,158,500)
Gjendja më 31 dhjetor 2016	2,856,529	17,027,691	30,857,432	30,224,414	195,276,666	276,242,732
<i>Amortizimi akumuluar</i>						
Gjendja më 1 janar 2015	624,510	2,925,842	3,948,819	5,312,436	-	12,811,607
Amortizimi i vitit	111,601	1,043,340	3,158,223	1,318,165	-	5,631,329
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2015	736,111	3,969,182	7,107,042	6,630,601	-	18,442,936
Amortizimi i vitit	118,922	1,571,407	3,759,825	1,179,736	-	6,629,890
Pakësime	-	-	(4,602,956)	-	-	(4,602,956)
Gjendja më 31 dhjetor 2016	855,033	5,540,589	6,263,911	7,810,337	-	20,469,870
<i>Vlera neto kontabël</i>						
Gjendja më 31 dhjetor 2015	2,120,418	5,231,380	14,928,890	5,584,602	169,196	28,034,486
Gjendja më 31 dhjetor 2016	2,001,496	11,487,102	24,593,521	22,414,077	195,276,666	255,772,862

Të gjitha vlerat janë në Lekë

10. Hua afatshkurtër

Huaja afatshkurtër më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Overdraft bankar	76,549,733	48,125,153
Pjesa afatshkurtër e huasë afatgjatë	28,929,559	-
Qira financiare pjesa afatshkurtër	2,706,512	-
	<u>108,185,804</u>	<u>48,125,153</u>

11. Llogari të pagueshme tregtare

Në këtë zë janë përfshirë llogaritë e pagueshme ndaj furnitorëve, balanca e së cilave më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Furnitorë	198,855,495	92,285,658
Furnitorë për fatura të pambërritura	6,394,217	-
	<u>205,249,712</u>	<u>92,285,658</u>

12. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Të pagueshmet ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Dividendë për t'u paguar	21,150,000	21,150,000
Detyrime të tjera ndaj ortakëve	71,298,866	71,098,866
	<u>92,448,866</u>	<u>92,248,866</u>

13. Parapagime të arkëtuara

Parapagimet e arkëtuara më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Parapagime të arkëtuara	63,548,548	3,004,164
	<u>63,548,548</u>	<u>3,004,164</u>

14. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Detyrime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	385,960	293,109
Detyrime për tatimin mbi të ardhurat personale	60,390	39,948
Detyrime për tatimin mbi fitimin	-	3,785,821
TVSH për t'u paguar	-	280,456
	<u>446,350</u>	<u>4,399,334</u>

MEKTRIN MOTORS sh.p.k.**Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

Të gjitha vlerat janë në Lekë

15. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera paraqesin detyrimet ndaj punonjësve më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Paga për t'u paguar	2,042,073	1,769,956
Detyrime të tjera	284,540	2,495,327
	<u>2,326,613</u>	<u>4,265,283</u>

16. Hua afatgjatë

Huaja afatgjatë më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Qira financiare pjesa afatgjatë	9,879,531	-
Kredi bankare Intesa San Paolo	149,469,400	-
	<u>159,348,931</u>	<u>-</u>

17. Kapitali

Kapitali i shoqërisë është 35,000,000 Lekë dhe zotërohet 100% nga ortaku i vetëm Z.Edmond Shahini.

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Numri i kuotave	100	100
Vlera nominale (në LEK)	350,000	350,000
Kapitali i nënshkruar	<u>35,000,000</u>	<u>35,000,000</u>

Rezerva të tjera

Rezerva të tjera paraqiten në vlerën 309,872,501 lekë.

Rezerva ligjore

Rezerva ligjore paraqitet në vlerën 1,750,000 lekë dhe përfaqëson 5% të kapitalit themeltar.

MEKTRIN MOTORS sh.p.k.
Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

Të gjitha vlerat janë në Lekë

18. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Të ardhura nga shitja e pjesëve të këmbimit për automjete	98,161,366	95,847,769
Të ardhura nga shitja e pjesëve të këmbimit për kamiona	2,403,736	6,363,467
Të ardhura nga shitja e automjeteve	1,075,480,257	1,470,464,259
Të ardhura nga shitja e kamioneve	89,050,515	43,956,307
Të ardhura nga shërbimet dhe riparimet	12,185,670	14,967,952
	<u>1,277,281,544</u>	<u>1,631,599,754</u>

Rakordimi i të ardhurave me FDP-në:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Qarkullim i tatueshëm	1,535,863,448
Zbriten autofaturimet 2016	(4,165,346)
Shtohen parapagimet e rimarra nga 2015	3,004,164
Zbriten parapagimet për periudhat e ardhshme	(56,316,448)
Shtohen diferencat e këmbimit nga aktiviteti operativ	847,159
Zbritet vlera kontabël neto e aktiveve të shitura paraqitur neto	(7,555,544)
Diferenca konvertim nga parapagimet	(36,686)
Shuma e qarkullimit e korrektuar	1,471,640,747
Sipas Kontabilitetit	1,471,640,747
Diferenca	<u><u>-</u></u>

19. Punë e kryer nga njesia ekonomike e kapitalizuar

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Të ardhura prodhim AQT Kapanone	188,092,079	-
	<u>188,092,079</u>	<u>-</u>

Të gjitha vlerat janë në Lekë

20. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Të ardhura nga komisionet	2.740.423	2.868.334
Të ardhura nga qiraja	1.489.215	400.000
Të ardhura nga shitja AAM-ve (paraqitur neto)	185.456	-
Të ardhura nga leasing	762.268	-
Të ardhura të tjera	242.603	-
Të ardhura nga këmbimet valutore	5.771.134	1.231.920
Humbje nga këmbimet valutore	(4.923.975)	(1.022.074)
	6.267.124	3.478.180
		Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
<i>Rezultati nga shitja e AAM-ve</i>		
Te ardhura nga shitja e aktiveve		7,741,000
Vlera kontabel neto e aktive te shitura		(7,555,544)
Rezultati neto		185,456

21. Lëndë të para dhe materiale të konsumueshme

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndëve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen më veprimtarinë e shfrytëzimit. Kostoja e mallrave të shitur dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Kosto e pjesëve të këmbimit për automjete	91,983,681	83,821,049
Kosto e pjesëve të këmbimit për kamiona	2,090,043	5,645,578
Kosto e automjeteve të shitura	996,108,987	1,311,682,920
Kosto e kamionëve të shitur	86,129,847	38,331,799
Të tjera material	3,639,271	5,104,098
	1,179,951,829	1,444,585,444
	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Punime ndërtimi kapanone	81,828,123	-
Punime të tjera	65,023,746	-
Kosto e materialeve të para	19,760,967	-
	166,612,836	-

Të gjitha vlerat janë në Lekë

22. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Shpenzime energji, avuj,ujë	1,674,064	2,457,283
Shpenzime qiraje	18,198,520	18,547,871
Qira financiare	-	2,474,265
Mirëmbajtje dhe riparime	1,378,986	1,333,212
Prime sigurimi	2,419,081	1,247,136
Shpenzime të ndryshme	2,041,191	1,108,227
Personel nga jashtë ndërmarrjes	3,600,777	2,874,025
Pagesa për honorare, ndërmjetës	443,728	-
Publicitet, reklama	5,597,073	3,186,342
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	1,176,591	1,209,537
Transferim, udhëtime, dieta	1,898,621	1,684,291
Taksa të ndryshme	571,668	513,373
Sherbime bankare	2,251,596	2,475,213
	<u>41,251,896</u>	<u>39,110,775</u>

23. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit të shoqërisë përgjatë vitit 2016 dhe 2015 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Shpenzime page	15,170,106	11,428,017
Shpenzime për sigurime shoqerore dhe shëndetësore	2,391,860	1,805,670
	<u>17,561,966</u>	<u>13,233,687</u>

24. Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi

Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë :

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Shpenzime amortizimi	6,629,890	5,631,329
	<u>6,629,890</u>	<u>5,631,329</u>

25. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjobat dhe penaltitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Gjoba të ndryshme	1,154,913	854,945
	<u>1,154,913</u>	<u>854,945</u>

Të gjitha vlerat janë në Lekë

26. Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme

Shpenzimet financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 detajohen si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Shpenzime për interesa	6,931,947	4,655,615
Qira financiare	2,112,008	-
Të ardhura nga interesat	(351,885)	(609,395)
	<u>8,692,070</u>	<u>4,046,220</u>

27. Shpenzime të tjera financiare

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Garanci Bankare Societe Generale Albania	(615,297)	-
Të ardhura të tjera	47,822	-
Të ardhura nga këmbimet valutore aktiviteti financiar	3,784,972	1,726,842
	<u>3,217,497</u>	<u>1,726,842</u>

28. Tatimi mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
<i>Fitimi para tatimit</i>	48.772.039	129.342.376
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë)	5.858.635	1.422.115
Penalitet, gjoba e dëmshpërblime	1.154.913	854.945
Zhvlerësim i llogarive të arkëtueshme	4.230.805	-
Shpenzime sigurim jete	-	315.070
Shpenzime të tjera	472.917	252.100
<i>Fitimi para tatimit</i>	<u>54.630.674</u>	<u>130.764.491</u>
<i>(përfshirë shpenzimet e panjohura)</i>		
<i>Tatim fitimi @15%</i>	8.194.601	19.614.674
	<u>40.577.438</u>	<u>109.727.702</u>

Të gjitha vlerat janë në Lekë

29. Palët e lidhura

Këto përfaqësojnë transaksionet me palët e lidhura, për shembull aksionerët e shoqërisë, dhe njësitë e kontrolluara, të kontrolluara bashkarisht ose që kanë një ndikim të konsiderueshëm nga palët e tilla.

Balancat me palët e lidhura të përfshirë në pasqyrën e pozicionit financiar detajohet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Të pagueshme ndaj ortakut	<u>92,248,866</u>	<u>92,248,866</u>
	<u>92,248,866</u>	<u>92,248,866</u>

30. Angazhime dhe pasiguri*Çështje gjyqësore*

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 dhjetor 2016 shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kerkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në menyrë të besueshme.

31. Ngjarje pas datës së raportimit financiar

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pasdatës së raportimit të cilat do të kërkonin korrigjim ose shënime në pasqyrat financiare.

Mazars

Address

Rruga Emin Duraku, Pall. "Binjaket", Nr.5
Tirane, Shqiperi
Tel. +355 (0) 42 278 015
audit@mazars.al

www.mazars.al

